



A. Hoxha

09.08.2017

A. H.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATE/A:	09.08.2017
REFERENC-Ë:	205/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
GA/OD/FROM:	^{PËR} Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Rekomandimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr. 15/2017 të dt.10.07.2017 për lëndën e Berzat Namlegji Nr.04-353-55402.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Rekomandimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sports
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve / Kosovo Institute for Protection of
Monuments / Institut Kosova za Zastitu Spomenika

WPS-MY 10
INSTITUT ZA ZASTITU SPOMENIKA I OMLADINE I SPORTA
THE KOSOVO INSTITUTE FOR CULTURAL MONUMENTS
403 # 08.08.2017
PPRINTIME

DATE/A:	10.07.2017
REFERENC-Ë:	15/2017 - Takimi i pesëmbëdhjetë
PËR/ZA/TO:	Z. Agim GËRGURI - U.D. Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.
CC:	Z. Bislim BİSLIMI - Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit / DL - MKRS, anëtar i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM; Znj. Zana LLONÇARI OSMANI- Zyrtare e Lartë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore - MKRS, anëtare e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM;
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Znj. Teuta SELMANAJ - Zyrtare Ligjore në IKMM, përgjegjëse për mbështetjen administrative të punës së Komisionit.
NGA/OD/FROM:	Znj. Merita AUGUSTININRECAJ - Kryesuese e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komisionit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave / projekteve: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Pejë dhe Prizren.

I nderuar Drejtor z. Gërguri,

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejme Komisioni) i emëruar me Vendimin Nr. 01/2016 të datës 13.04.2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin tjetër Nr. 52/2016 të datës 04.10.2016 me Nr. të protokollit 376, i ndryshuar dhe plotësuar, ka zhvilluar takimin e pesëmbëdhjetë (15) punues me datë 28.06.2017, ku janë shqyrtuar kërkesat dhe projektet e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK)-Pejë dhe Prizren. Janë dhënë rekomandimet si në vijim:

Rreth kërkesës Nr. 4. ORTK - Prizren:

4. Berzat Namlegjiu nga Prizreni ka parashtruar kërkesen për ndërtimin e shtëpisë individuale për banim në ngastrën kadastrale me numër 02182-0. Etazhiteti i objektit ekzistues është P+1 ndërsa etazhiteti i ri do të jetë B+P+2. Objekti që do të ndërtohet gjendet në zonën e VI-të sipas Planit të Konservimit ku etazhiteti i lejuar është P+2 (lartësia maksimale deri të streha është 9.5 m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet deri 60% e sipërfaqës së parcelës. Në afërsi të parcelës ku do të ndërtohet objekti gjindet Shtëpia e Musa Shehzadës që gjindet në listën e MKRS.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, vlerëson se kërkesa projekti në fjalë, nënkupton rrënimin e objektit ekzistues. Ky objekt është njësi përbërëse e Qendrës Historike të Prizrenit vlerat dhe karakteristikat e së cilës, mbrohen si tërësi me Ligjin për Qendrën Historike dhe Planin përkatës të konservimit. Për këtë arsye ky projekt refuzohet ndërsa njoftohet pala se intervenimet e lejuara në këtë kategori objektësh janë aplikimet plotësuese të cilat mundësojnë të ruajnë dhe mbrojnë karakterin e arkitekturës së mbrojtur sipas kriterëve të përcaktuara në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit.